



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke/ Ministry of Education,
and Science

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01-50
Datë: 22.07.2020

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nenit 49 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 17, 16 shtator 2011), nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 6/2020 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e dt. 06.06.2020, nenit 4 të Rregullores (QRK) – nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) – nr. 06/2020, shtojca 11 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dt. 16.06.2020, nxjerr:

V E N D I M

Për ndarje të bursave për regjistrim të femrave në drejtime teknike në institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional

1. Ndahet buxheti për bursa për regjistrim të femrave në drejtime teknike në institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional (IAAP) për vitin shkollor 2020 -2021.
2. MASH dhe Projekti LuxDev KSV/020 (MASH dhe Projekti, për vitin e parë kontribuojnë me nga 10,000.00€).
3. Buxheti menaxhohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH).
4. Kushtet dhe kriteret për bursa për profilet e përcaktuara në vendim janë si në vijim:
 - 4.1. Të jenë shtetase të Republikës së Kosovës;
 - 4.2. Suksesi i shkollimit paraprak – klasat 6-9;
 - 4.3. Rezultatet e testit të arritshmërisë nëse këtë vit shkollor mbahet testi i arritshmërisë për arsye të Pandemisë Covid 19.
5. Nxënësit të cilët i plotësojnë kushtet sipas paragrafit 4 të këtij vendimi duhet të prezantojnë këto dokumente:

- 5.1. Kërkesën për bursë;
 - 5.2. Certifikatën e shkollës së mesme të ulët;
 - 5.3. Certifikatën e lindjes.
6. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit bëhet në IAAP.
 7. Drejtorët e IAAP-ve, i dorëzojnë aplikacionet në MASHT.
 8. Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.
 9. Nxënëset aplikojnë për bursë në IAAP ku pretendojnë të regjistrohen, ndërsa drejtori/i apo i autorizuari i IAAP, i dorëzon aplikacionet në MASH.
 10. Aplikacionet për bursë shqyrtohen nga komisioni i veçantë i themeluar nga MASH me këtë përbërje:
 - 10.1. Departamenti i AAP (1);
 - 10.2. IAAP, drejtori (1);
 - 10.3. IAAP, mësimdhënës i profileve teknike (1);
 - 10.4. IAAP, mësimdhënës në bazë të profileve deficitare (1);
 - 10.5. IAAP, përfaqësuesi i këshillit të prindërve (1)
 - 10.6. IAAP, përfaqësuesi i këshillit të nxënësve (1);
 - 10.7. Donatori që mbështet këtë aktivitet, në rast se nuk ka donatorë përfaqësohet nga DAAP(1).
 11. Pas shqyrtimit të aplikacioneve, komisioni i veçantë përgatit raport dhe ia dorëzon ministrit për nënshkrim.
 12. Komisioni i veçantë i raporton në baza periodike dhe sipas kërkesës, ministrit të MASH.
 13. Për vitin shkollor 2020 – 2021, do të ndahen 40 bursa dhe secila nxënëse do të përfitoj 500.00 € në bazë vjetore (€50 për çdo muaj, duke përjashtuar muajt korrik dhe gusht).
 14. Për këtë vit shkollor, të gjitha nxënëset të cilat me sukses e përfundojnë klasën e 9-të, mund të aplikojnë për bursa në njërin nga profilet në vijim:
 14. 1. Instalues elektrik;
 14. 2. Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit;
 14. 3. Automekanik.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë si dhe duke pasur parasysh nevojën e stimulimit të femrave për regjistrim në drejtime teknike në institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional (IAAP) për vitin shkollor 2020 -2021 si dhe duke pasur parasysh se donator Projekti, LuxDev KSV/020 po jep donacion prej 10.000 € për vitin e parë shkollor 2020-2021, u vendos si në dispozitiv të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Donatorit;
2. Kabinetit të Ministrisë;
3. Sekretarit të përgjithshëm,
4. Institucioneve të arsimit dhe aftësisimit profesional (IAAP);
5. DAAP;
6. Departamentit ligjor;
7. Dep. të financave dhe shërbimeve të përgjithshme;
8. Arkivit.

Ramë Likaj

Ministër/MASH

